



**REPUBIKA E SHQIPERISE**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë

E-mail: [klsh@org.al.com](mailto:klsh@org.al.com) web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 1463 Prot.

Tiranë, më 31.12.2018

**VENDIM**

Nr. 254, Datë 31.12 .2018

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PROCEDURAVE TË AUDITIMIT NË KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe Vendimit nr.166, datë 26.11.2018 "Pë një ndryshim në Vendimin nr.4, datë 27.01.2017 "Mbi miratimin e strukturës organizative të Kontrollit të Lartë të Shtetit, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave" i ndryshuar"

**VENDOSA:**

1. Në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, të miratuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 bëhen ndryshimet si më poshtë:
  - Në nenin 31, pika 6 fjalët "Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve" zëvendësohet me fjalët "Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë";
  - Në nenin 33, pika 1, fjalët "Departamentit Juridik, dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, e sipas rëndësisë, Drejtori i Përgjithshëm/Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit Juridik" zëvendësohet me fjalët "Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, nga Departamenti Juridik e sipas rëndësisë Drejtori i Përgjithshëm";
  - Në nenin 34, pika 8, fjalët "Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve" zëvendësohet me fjalët "Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë";
  - Në nenin 35, pika 1, fjalët "Juridik dhe Zbatimit të Standardeve të Auditimit" zëvendësohet me fjalët "të Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë"; pika 5, fjalët "Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve" zëvendësohet me fjalët "Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë"; pika 6, fjalët "Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve" zëvendësohet me fjalët "Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë"; pika 8, fjalët "Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve" zëvendësohet me fjalët "Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë";
  - Në nenin 38, pas pikës 5, shtohen pikat 5.1 dhe 5.2 me këtë përmbajtje:
  - 5.1. Pas Vendimit të Kryetarit në të cilin ka rekomandim për kallëzim penal, Departamenti Juridik merr dosjen e auditimit dhe e shqyrton për përcaktimin në se ka



ose jo elementë të veprës penale. Në se Departamenti Juridik nga shqyrtimi i dosjes së auditimit konstaton elementë të veprës penale, në bashkëpunim me grupin e auditimit, përgatit dokumentet e nevojshme dhe ndjek procedurat për kallëzim penal të çështjes nën shqyrtim, brenda **një javë (dhe deri në dy javë në raste të veçanta)** nga protokollimi i Vendimit të Kryetarit.

- 5.2. Në se nga Departamenti Juridik nuk konkludohet në kohë sipas afateve të mësipërme, Departamenti përkatës i auditimit përgatit përcjelljen e materialit në Prokurori si Indicie Penale, duke i vënë në dispozicion një kopje të këtij materiali Departamentit Juridik. Drejtori i Departamentit Juridik dhe/ose Kryeaudituesi kur Drejtori i Departamentit është i ngarkuar me punë, caktojnë 1, 2 juristë nga Departamenti Juridik që ndjekin indicien, si dhe një jurist ose auditues në bashkëpunim me Departamentin përkatës të auditimit, nëse është e nevojshme.
  - Në nenin 39, pika 3 dhe 11 hiqen fjalët “dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve”;
  - Në nenin 40, pika 4 fjalët “dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”, si dhe në pikën 5 fjalët “Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”;
  - Në nenin 42, pika 16 fjalët “Departamentit dhe Departamenti Juridik dhe Zbatimit të Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë” dhe në pikën 19 hiqen fjalët “dhe Zbatimit të Standardeve”;
  - Në nenin 43, pika 16, fjalët “Departamentit dhe Departamenti Juridik dhe Zbatimit të Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”;
  - Në Dokumentet, pjesë e kësaj Rregulloreje: në Dokumentin 4 fjalët “Departamenti Juridik i Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”; në Dokumentin 15 fjalët në paragrafin hyrës “Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”; po në këtë dokument në kreun GJ. Kallëzime penale, hiqen fjalët “dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës” dhe ngelen vetëm fjalët “Departamenti Juridik”, si dhe në Udhëzimet për plotësimin e Vendimit (Projekt) tek pika 10 fjalët “*Departamentit Juridik dhe Kontrollit Zbatimit të Standardeve*” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”; në Dokumentin 16, fjalët “Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë”
2. Të gjitha vendimet në këtë periudhë tranzitore që kanë Indicie Penale shqyrtohen nga Departamenti Juridik, për t’u plotësuar apo për t’u përgatitur për në Gjykatë, mbas përfundimit të hetimit nga Prokuroria, cilido që të jetë konkluzioni i tyre.
3. Në rastet e thirrjeve për pjesëmarrje në gjyqe, KLSH do të përfaqësohet nga një jurist nga Departamenti Juridik dhe nga një jurist ose auditues nga Departamenti përkatës i auditimit, dhe në raste të veçanta për arsye objektive nga Drejtori i Departamentit Juridik, në se kërkohet nga Drejtori i Departamentit Juridik ose Drejtori i Departamentit përkatës të auditimit për të mbrojtur kallëzimin ose Indicien Penale të përgatitur.
4. Të gjithë Urdhrat e mëparshëm të dala gjatë periudhës tranzitore të kryerjes së ndryshimeve dhe që bien ndesh me këtë Rregullore shfuqizohen. Brenda muajit shkurt 2019, Zv.Kryetari i deleguar në pozicionin e Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm. Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtori i Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, plotësojnë Rregulloren e Procedurave të Auditimit me këto ndryshime dhe të tjera që mund të gjykohen, veçanërisht për sa i përket dokumentit të Programit të Auditimit sipas standardeve, dhe miratojnë Rregulloren e re të Procedurave të Auditimit.

5. Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit me ndryshimet e mësipërme, hyn në fuqi më datë 03.01.2019.

6. Sekretari i Përgjithshëm. Drejtorët e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Departamenteve të marrin masa për njohjen dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje nga stafi i KLSH, përfshirë dhe publikimin e Rregullores me ndryshimet përkatëse në website-n e KLSH në ditët e para të janarit 2019.

**KRYETAR**

**Bujar LESKAU**

